



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 19.4.2021

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 19.4.2021, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Anton Martini, konfirmuar në detyrë me anë të vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 65 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Kolegji i Posaçëm i Apelit zhvilloi, më datë 1.4.2021, ora 14:00, seancën gjyqësore publike të çështjes (JR) 28/2020, datë 10.7.2020, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që lidhet me subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini.

Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, pasi palët konfirmuan marrjen e denoncimeve të vëna në dispozicion nga Kolegji dhe mbi bazën e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të lejojë marrjen në cilësinë e provës të akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit. Rezulton se trupi gjykues vendosi ta shtyjë seancën gjyqësore për sot, datë 19.4.2021, për t’u dhënë mundësinë palëve të mbajnë qëndrimin e tyre lidhur me provat e reja të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe denoncimet.

Sa më sipër, Kolegji, me shkresën nr. ***/**, datë ***.4.2021, ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerit Publik, të inventarizuara, aktet e lejuara nga trupi gjykues për t’u marrë në cilësinë e provës, të depozituara në seancat gjyqësore publike nga subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, konkretisht:

1. Shkresë, Këshilli i Lartë të Prokurorisë, datë ***.3.2021, nr. ***/***/ex***/***/ prot. (4 fletë);
2. Shkresë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, datë ***.12.2019, nr. ***/***/ prot. (2 fletë);
3. Shkresë, Ministria e Drejtësisë, datë ***.3.2021, nr. A-***/***/ prot. (15 fletë);

4. Letër reference, datë ***.11.2020, lëshuar nga Nordic Police and Customs co-operation (*Zyra Ndërlidhëse e Vendeve Nordike për Bashkëpunimin Policor dhe Doganor Shqipëri dhe Kosovë*), në gjuhën shqipe dhe angleze (4 fletë);
5. Certifikatë sigurie, lëshuar nga DSIK, datë ***.3.2021 (2 fletë);
6. Shkresë kthim përgjigje, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, datë ***.3.2021, nr. ***/*** prot. (5 fletë);
7. Shkresa e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dërgohet vendimi për dhënien e mbrojtjes së veçantë prokurorit Anton Martini, nr. *** prot., datë ***.2.2020 (4 fletë);
8. Shkresë, dërgohet vendimi për dhënien e mbrojtjes për prokurorin Anton Martini, nr. ***/*** prot., datë ***.3.2021 (4 fletë);
9. Shkresë kthim përgjigje kërkesës së depozituar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nr. ***/*** prot., datë ***.3.2021 (55 fletë);
10. Shkresë kthim përgjigje kërkesës depozituar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë (2 fletë);
11. Shkresë kthim përgjigje SPAK, drejtuar prokurorit Anton Martini, nr. ***/*** prot., datë ***.3.2021 (5 fletë);
12. Shkresë kthim përgjigje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, drejtuar prokurorit Anton Martini, nr. *** prot., datë ***.1.2021 (2 fletë);
13. Shkresë kthim përgjigje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, drejtuar prokurorit Anton Martini, nr. *** prot., datë ***.3.2021 (12 fletë);
14. Shkresë kthim përgjigje, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, drejtuar prokurorit Anton Martini, nr. ***/*** prot., datë ***.2.2021 (7 fletë);
15. Shkresë konfirmim TIMS, për hyrje dalje e shtetasit *** ***, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nr. ***/*** prot., datë ***.12.2020 (2 fletë);
16. Vendim, Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, nr. ***, datë ***.4.2014, (4 fletë);
17. Vendim, Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, nr. ***, datë ***.12.2013 (3 fletë);
18. Dokumentacion në gjuhën angleze, protocol number ***/*** (114 fletë);
19. Deklaratë zëvendësuese e aktit noterial, noter *** *** (7 fletë);
20. Lajme të publikuara në mediat e shkruara dhe ato elektronike (75 fletë);
21. Kërkesë për marrje informacioni drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (1 fletë).

1. *Lidhur me provat e reja në raport me shkaqet e ankimit.* Në referencë të përmbajtjes së këtyre akteve dhe nivelit të provueshmërisë në lidhje me shkaqet e ankimit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, aktet e sipërlistuar, me numër rendor nga nr. 1-14, 16-17, si dhe 20 - 21, ashtu sikurse dhe u parashtrua nga subjekti i rivlerësimit, z. Martini, gjatë seancës gjyqësore të datës 30.3.2021 dhe sikurse janë trajtuar në dokumentin e depozituar: *“Provat dhe çfarë synojmë të provojmë”*, kanë të bëjnë kryesisht¹ me të dhëna dhe informacione mbi veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

¹ Përveç shkresës së Ministrisë së Drejtësisë, datë ***.3.2021, nr. ***-***/** prot. (15 fletë), Kërkesë për marrje informacioni, lidhur me relacionin shoqëruar të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 25.3.2020, *“Për marrjen e*

1.1 Komisioneri Publik konstaton se aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit nuk ndikojnë në shkaqet e ankimit, të cilat janë ngritur bazuar në të dhënat e situatave ligjore dhe faktike të provuara gjatë hetimit administrativ, nga burimet për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale sipas procedurës të përcaktuar në ligjin nr. 84/2016.

1.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, aktet e sipërlistuara, të administruara nga trupi gjykues, në cilësinë e provës, nuk vërtetojnë rrethana të ndryshme nga sa është hetuar dhe dokumentuar nga ana e Komisionit gjatë hetimit administrativ dhe sa është parashtruar nga Komisioneri Publik, në shkaqet e ankimit para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për kriterin rivlerësues të aftësive profesionale, si dhe vlerësimit tërësor të çështjes, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

2. Në analizë të shkakut të ankimit mbi: *“Burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë”*, nënçështjes: *“Lidhur me të ardhurat e dhuruara nga vëllezërit për periudhën 2011 – 2016”*, nga subjekti i rivlerësimit rezulton se janë paraqitur aktet e sipërlistuara me numër rendor 18 - 19.

2.1 Subjekti i rivlerësimit, në dokumentin e depozituar: *“Provat dhe çfarë synojmë të provojmë”*, bazuar në përmbajtjen e këtyre akteve, ka pretenduar të dokumentojë mundësinë financiare të vëllait ***. ***. për të krijuar me burime të ligjshme, shumat e deklaruara nga subjekti si të dhuruara për vitet 2012-2015, duke dokumentuar të ardhurat e realizuara nga shtetasja ***. ***. ***. (bashkëshortja e shtetasit ***. ***.); si dhe mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit për udhëtimin e familjes së tij, në datat 20-27 qershor 2012, në Itali, nga shtetasit *** *** në Ancona, Itali.

2.2 Në përfundim të analizës së provave/aktit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për këtë nënçështje të ankimit, lidhur me të ardhurat familjare të vëllait ***. ***., Komisioneri Publik vlerëson se, edhe në konsideratë të ndikimit të tyre në situatën financiare të subjektit për këto vite, aktet e sjella nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, bazuar në shkaqet e tjera të ankimit mbi mungesën e burimeve për krijimin e pasurisë.

3. Në analizë të shkakut të ankimit lidhur me vlerësimin profesional: *“Të dhëna nga burime arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, pjesë të Raportit të rivlerësimit për subjektin Anton Martini, hartuar nga GPPP, si organi i vlerësimit të aftësive profesionale - mbi ankesën e gazetarit ***. ***.”*, nga subjekti i rivlerësimit rezulton se është paraqitur akti i sipërlistuar, me numër rendor 15, *“Shkresë konfirmim TIMS, për hyrje dalje e shtetasit *** ***, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nr. ***/*** prot., datë ***.12.2020 (2 fletë)”*.

3.1 Subjekti i rivlerësimit, në *Parashtesën* e paraqitur pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: *[...] Në datë ***.7.2013 u urdhërua dhe thirrja e kallëzuesit ***. ***, por ai nuk u paraqit asnjëherë para Of. Pol. Gjyqësore, pasi më datë ***.7.2013 largohet nga Shqipëria në drejtim të një vendi të BE-së, ku dhe kërkoi AZIL, duke u munduar të shfrytëzojë këtë rast që tashmë prokuroria po e hetonte. Gjatë gjithë hetimit dhe gjyqimit të kësaj çështjeje, ky shtetas nuk ka qenë në Shqipëri, fakt i cili vërtetohet nga të dhënat e sistemit TIMS për këtë shtetas [...].*

masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.”

3.2 Komisioneri Publik, në ankimin e paraqitur, ka parashtruar se, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti konkret, si dhe vlerësimin tërësor të çështjes, ka vlerësuar se elementet e evidentuara lidhur me veprimet/mosveprimet e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, janë elemente të mjaftueshme për t'u konsideruar në raport me nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

3.3 Në përfundim të analizës së provës/aktit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi, në vlerësimin e Komisionerit Publik, kjo provë nuk pasqyron ndonjë situatë të ndryshme nga sa është dokumentuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe nga sa është parashtruar nga Komisioneri Publik, në shkaqet e ankimit.

4. Lidhur me denoncimet në raport me shkaqet e ankimit: Kolegji, me shkresën nr. ***/***, datë ***.4.2021, ka informuar se në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini, janë paraqitur 3 denoncime, konkretisht:

- Nr. ***/*** prot., datë ***.1.2020, që i përket denoncuesit ***. ***. (1 fletë), denoncim i cili është përcjellë Institucionit të Komisionerit Publik nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. ***/*** datë ***.1.2020, protokolluar në IKP me nr.*** prot., datë ***.1.2020.

- Nr. ***/*** prot., datë ***.2.2021, që i përket denoncuesit ***. ***. (6 fletë); denoncim i protokolluar me nr. ***/***, datë ***.6.2020, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, trajtuar shkurtimisht dhe në ankimin e paraqitur. Komisioneri Publik, bazuar në nenin F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, nëse Kolegji e vlerëson të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, ka sjellë në vëmendje të Kolegjit, këtë denoncim të depozituar në IKP, krahas denoncimeve të publikut për këtë subjekt rivlerësimi, të administruara ndërkohë nga vetë Kolegji.

- Nr. ***/*** prot., datë ***.2.2021, që i përket denoncuesit ***. ***. (6 fletë), denoncim i cili është përcjellë Institucionit të Komisionerit Publik nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit me shkresën nr. ***/*** datë ***.2.2021, protokolluar në IKP me nr.***/*** prot., datë ***.2.2021.

4.1 Komisioneri Publik, në zbatim të detyrës së lënë nga trupi gjykues, ndër të tjera, dhe për të shprehur qëndrimin mbi denoncimet e depozituara në Kolegj për subjektin e rivlerësimit, z. Martini, për sa trajtuar në shkaqet e ankimit kundër vendimit nr. 231/2020 të Komisionit, vlerëson se:

4.1.1 Për sa kohë denoncimet e përcjella nga ana e Kolegjit: (i) përmbajnë elementet e përcaktuar nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016, (i.i) përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen, (i.ii) gjeneralitetet e denoncuesit dhe numrin e kontaktit, (ii) në konsideratë të faktit se çelja e hetimit gjyqësor në gjykimin e ankimit të Komisionerit Publik për rastin konkret, është vendosur bazuar në (ii.i) kërkesën e subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik e lë në çmimin e trupit gjykues, shqyrtimin e vlerës provuese të këtyre denoncimeve të administruara.

4.1.2 Ndërkohë, në vijim të përfundimeve të arritura nga shqyrtimi i shkaqeve të ankimit, konstatimet e rezultuara nga shqyrtimi i vendimit nr. 231/2021, në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, bazuar në aktet e fashikullit të hetimit administrativ të Komisionit dhe

raportit të Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Publik i vlerëson si të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar, se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.

4.1.3 Në këto kushte, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, në lidhje me nevojën e shqyrtimit gjyqësor vetëm të atyre shkaqeve që konsiderohen të mjaftueshme për të arritur në vendimmarrjen përfundimtare për çështjen², Komisioneri Publik, për efekt të këtij procesi, vlerëson se eventualisht, çdo konkluzion lidhur me këto denoncime të administruara, nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin mbi shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik dhe kërkimin e tij³.

5. Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik, duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të paraqitur prej tij, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

² Referohuni vendimit (JR) nr.15/2019 pgr.118; vendimi (JR) nr.11/2018 pgr.7; vendimi (JR) nr.3/2019 pgr.30, etj.

³ Referohuni vendimit nr.27/2019 pgr.69-70.